



Prishtinë, 29 mars 2018
Kodi i ZRRE-së: V_934_2018

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji

Duke u bazuar në:

- Nenin 9 paragrafi 1 nënparagrafi 1.7, nenin 15 paragrafi 1 nënparagrafi 1.15, nenin 25, neni 26 paragrafi 1 nënparagrafi 1.2 dhe nenin 43 paragrafi 1 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Nr.05/L-184);
- Nenin 16 paragrafin 4 të Rregullës për Procedurën e Autorizimit për Ndërtimin e Kapaciteteve të reja;
- Vendimi për Lëshimin e Autorizimit Final V_760_2016 të datës 28 janar 2016 për shoqërinë "Matkos Group" SH.P.K., për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese për prodhimin e energjisë elektrike nga uji, HC Shtërpce me kapacitet të instaluar prej 5.031 MW, ZK Shtërpce, komuna e Shtërpçës;
- Kërkesën për shtyrjen e afatit të vlefshmërisë së Vendimit për Autorizim Final V_760_2016 i datës 28 janar 2016 edhe për 1 (një) vit, për ndërtimin e kapacitetit të ri gjenerues për prodhim të energjisë elektrike nga Uji, HC Shtërpce me kapacitet të instaluar prej 5.031 MW, ZK Shtërpce, komuna e Shtërpçës, të datë 11.01.2018 nr. prot. 015/18 të shoqërisë "Matkos Group" SH.P.K., me adresë rruga "Veternik" 10000, Prishtinë, Republika e Kosovës,

në seancën e mbajtur me datë 29 mars 2018 nxori këtë:

V E N D I M

- I. **APROVOHET** kërkesa e shoqërisë "Matkos Group" SH.P.K. dhe **SHTYHET** afati i vlefshmërisë së Autorizimit Final V_760_2016 i datës 28 janar 2016, për vazhdimin e ndërtimit të Hidrocentralit HC Shtërpce me kapacitet të instaluar prej 5.031 MW, ZK Shtërpce, komuna e Shtërpçës, edhe për 1 (një) vit, gjegjësisht deri me **28 janar 2019 për ndërtimin e Hidrocentralit.**

A r s y e t i m

- o ZRRE me datë 29.03.2013 nga shoqëria "Matkos Group" SH.P.K., ka pranuar aplikacionin për marrjen e autorizimit për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese për prodhim të energjisë elektrike nga Uji, në Lumin Lepenc, për katër (4) njësi gjeneruese, HC Shtërpce me kapacitet të



instaluar prej 2.47 MW, HC Bitinje 2.1 MW, HC Vica 2.5 MW dhe HC Brod 2.5 MW, të gjitha në Komunën e Shtërpçës.

- Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji, pas analizimit të dëshmimeve të prezantuara nga shoqëria “Matkos Group” SH.P.K., ka vendosur se aplikuesi ka dëshmuar përshtatshmërinë për zhvillimin e projektit për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese nga Uji, dhe ka lëshuar Vendimin mbi Njoftimin për Autorizimin Preliminar V_541_2013 me datë 28 qershor 2013. Vendim mbi Njoftimin për Autorizimin Preliminar, nuk ka nënkuptuar edhe lëshimin e Autorizimit, përderisa nuk plotësohen kërkesat e përcaktuara me Rregullën e Procedurës së autorizimit për ndërtimin e kapaciteteve të reja.
- ZRRE me datë 24.06.2015 nga shoqëria “Matkos Group” SH.P.K., ka pranuar kërkesën për vazhdimin e afatit të vlefshmërisë së Vendimit V_541_2013 të datës 28 qershor 2013 mbi Njoftimin për Autorizimin Preliminar për HC Shtërpçe, Komuna e Shtërpçës, për kompletimin e aplikacionit për marrjen e Autorizimit Final.
- Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji, pas analizimit dhe vlerësimit të kërkesës dhe dëshmimeve relevante të prezantuara nga shoqëria “Matkos Group” SH.P.K., me datë 16.07.2015 ka vendosur me Vendimin V_744_2015 për shtyrjen e afatit të vlefshmërisë së Vendimit V_541_2013 të datës 28 qershor 2013, edhe për 6 (gjashtë) muaj, gjegjësisht deri me 28 dhjetor 2015, në mënyrë që brenda kësaj periudhe të kompletohet aplikacioni sipas legjislacionit në fuqi.
- ZRRE me datë 12.11.2015 nga shoqëria “Matkos Group” SH.P.K., ka pranuar kërkesën për shndërrimin e Vendimit mbi Njoftimin për Autorizimin Preliminar për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese për prodhim të energjisë elektrike nga Uji në Autorizim Final për HC Shtërpçe me kapacitet të instaluar prej 5.031 MW, në Lumin Lepenc lokacionin ZK “Shtërpçe”, Komuna e Shtërpçës, duke i bashkangjitur dëshmitë e lëshuara nga autoritetet relevante për përmbushjen e të gjitha kërkesave mjedisore, të drejtën mbi shfrytëzimin e tokës, të drejtat mbi shfrytëzimin e ujit, Lejen Ndërtimore dhe kërkesat e tjera ligjore që lidhen me natyrën e projektit sipas legjislacionit në fuqi.
- Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji, me datë 28.01.2016 ka vendosur që shoqërisë “Matkos Group” SH.P.K., ti lëshohet Autorizimi Final V_760_2016 për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese, për prodhimin e energjisë elektrike nga Uji, për HC Shtërpçe me kapacitet të instaluar prej 5.031 MW, njësia gjeneruese që do të vendoset në lokacionin ZK Shtërpçe, Komuna e Shtërpçës.
- ZRRE me datë 11.01.2018 nga shoqëria “Matkos Group” SH.P.K., ka pranuar kërkesën për vazhdimin e afatit të vlefshmërisë të Vendimit për Autorizimin Final V_760_2016 të datës 28 janar 2016, për HC Shtërpçe me kapacitet të instaluar prej 5.031 MW, **për përfundimin e ndërtimit edhe për një (1) vit, gjegjësisht deri me 28 janar 2019.**
- Kompania “Matkos Group” SH.P.K., thekson se, pas pranimit të vendimit V_760_2016 të datës 28 janar 2016 për lëshimin e autorizimit për ndërtimin e hidrocentrali HC Shtërpçe, ka filluar menjëherë me përgatitjet e fillimit të punimeve dhe ka vazhduar me intezitet të lartë në realizimin e këtij projekti dhe deri më tani ka arritur të përfundoj disa punë në Veprën e Marrjes, dhe po ashtu është hapur rruga për vendosjen e tubacionit Gypit (tubacion), dhe sipas dinamikës



së punimeve dhe kushteve klimatike do të përfundojmë ndërtesën e hidrocentralit (Power House) pozicioni i të cilës është dizajnuar nga prodhuesi i turbinave, dhe poashtu është duke u punuar në largpërçuesin deri te nënstacioni në Shtërpce.

- Shoqëria “Matkos Group” SH.P.K., në kërkesën e saj ka sqaruar se: arsyeja, pse po kërkojmë që të shtyhet afati i vlefshmërisë së autorizimit final për projektin HC Shtërpce është se edhe përkundër angazhimeve në përfundimin e realizimit të këtij projekti me interes, ky projekt nuk ka arritur të përfundohet brenda afatit të parë të caktuar nga ZRRE, për shkak të problemeve të vazhdueshme dhe vështirësive teknike në teren, dhe të projekteve tjera që janë duke i realizuar, dhe marr parasysh faktin që Projektet e “Matkos Group” SH.P.K., janë të tipit kaskad, është dashtë që të pritet edhe përfundimi i projektit HC Brezovica, që tani më është përfunduar brenda afateve dhe është në prodhim nga muaji Prill 2017. Poashtu ka sqaruar se janë në proces të ndërtimit edhe të HC Vica dhe të HC Sharri dhe sipas dinamikës priten të finalizohen bashku me projektin HC Shtërpce.
- Kompania Matkos Group SH.P.K., ka sqaruar se deri më tani ka finalizuar projektin HC Brezovica me kapacitet prej 2.1 MW, i cili projekt është finalizuar brenda afateve ligjore, edhe përkundër faktit dhe vështirësive të mëdha që janë dalur gjatë punimeve, kanë arritur të finalizojnë projektin e HC Brezovica, dhe nga muaji prilli i vitit 2017 është në prodhim komercial e për të cilën kanë lidhur Marrëveshjen për Blerje të Energjisë fillimisht me KESCO e tani më e kanë bartur marrëveshjen në KOSTT sipas udhëzimeve të ZRRE-së, dhe në pajtim me rregullat në fuqi.
- Kompania “Matkos Group” SH.P.K., gjithashtu ka sqaruar se është duke e realizuar edhe projektin HC Vica, i cili projekt sipas dinamikës së punimeve dhe rezultateve nga terreni do të finalizohet gjatë vitit 2018, ku deri më tani kanë finalizuar më shumë se 60 % të punimeve në teren, janë porositur edhe turbinat dhe bazuar në kushtet klimatike do të finalizohet dhe do të fillon operimin e prodhimit të energjisë elektrike.
- Poashtu ka sqaruar se edhe përkundër vështirësive në teren edhe njëherë theksojnë se deri më tani kemi bërë një progres të dukshëm në ndërtimin e Hidrocentralit HC Shtërpce, ku janë kryer shumë pune ndërtimore, edhe përkundër faktit se kanë filluar me disa vonesa për shkak edhe të projekteve tjera që janë duke i realizuar, të cilat kanë specifikat e veta, kanë vonesa në përfundimin e këtij projekti pasi që janë detyruar të fillojmë punimet sipas udhëzimeve të organeve kompetente të komunale dhe të Ministrisë së Mjedisit.
- Kompania “Matkos Group” SH.P.K., në lidhje me verifikimin e realizimit të këtyre punëve të lartcekura për projektin, HC Shtërpce, HC Vica dhe HC Sharri të cilat është duke i realizuar kompania në fjalë, me datë 19 Tetor 2017 Inspektorati i Ministrisë së Ambientit ka qenë në vend punishte, ku janë duke u kryer punimet nga kompania jonë, dhe është verifikuar nga Inspektorati MMPH që të tri projektet janë në zhvillim e sipër, sipas dinamikës së punimeve dhe kushteve ligjore dhe kanë theksuar se ka progres të dukshëm, e për të cilën gjeni bashkangjitur edhe procesverbalin nr. 17-ins P-30- vs-12 mbi Inspektimin e Punimeve nga Ministria e Ambientit.
- Andaj, marr parasysh faktin dhe natyrën komplekse të projekteve në fushën e Hidrocentraleve dhe specifikave si dhe terreneve të vështira në përfundimin e ndërtimit të këtij hidrocentrali, të cilat kanë qenë bazë e vonesave për fillimin dhe përfundimin e projektit në fjalë, shoqëria “Matkos Group” SH.P.K., bazuar në dispozitat e nenit 16 paragrafi 4 i Rregullës së Procedurës së Autorizimit, ka kërkuar nga Bordi i ZRRE që për Hidrocentralin HC Shtërpce me kapacitet të



instaluar prej 5.031 MW, ZK Shtërpce, komuna e Shtërpcës, të i mundësohet shtyrja e afatit edhe për 1 (një) vit, gjegjësisht deri me **28 janar 2019** për përfundimin e projektit në fjalë.

- Bordi i ZRRE-së, pas analizimit të kërkesës së shoqërisë "Matkos Group" SH.P.K., dhe dëshmime të bashkangjitura për shtyrje të afatit të vlefshmërisë të Autorizimit Final, për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese për prodhimin e energjisë elektrike nga uji, në Lumin Lepenc HC Shtërpce me kapacitet të instaluar prej 5.031 MW, në Komunën e Shtërpcës, ka vlerësuar ato, dhe ka konsideruar se për shkak pengesave të paraqitura dhe të kompleksitetit të ndërtimit të Hidrocentraleve, dhe duke u mbështetur në shkresat e lëndës, ka vendosur që të lejohej shtyrja e afatit të vlefshmërisë së Autorizimit Final V_760_2016 i datës 28 janar 2016, edhe për një afat shtesë ligjor, duke u mbështetur në dispozitat ligjore të cekura në hyrje të këtij vendimi.

II. Vendimi për Lëshimin e Autorizim Final V_760_2016 i datës 28 janar 2016, do të vlen deri me datë **28 janar 2019**, sipas dispozitivin nën pikën I., të këtij vendimi, në rast se nuk arrin të përfundoj ndërtimin e stabilimenteve të reja gjeneruese nga Uji, apo nuk vepron në pajtim me legjislacionin në fuqi, vendimi do të shfuqizohet.

III. Vendimi nxirret dhe publikohet në gjuhët zyrtare në Republikën e Kosovës.

IV. Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi, dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.

Këshillë juridike: Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të inicioj konflikt administrativ në Gjykatën Kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimit të Vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodh e fundit.

Bordi i ZRRE-së:

Arsim Janova, u.d. Kryesues

Besim Sejfiqaj, anëtar

Selman Hoti, anëtar

Izet Rushiti, anëtar

Vendimi iu dërgohet:

- Palës,
- Komunës së Shtërpcës,
- Sekretarit të Përgjithshëm të MMPH-së, dhe
- Arkivit të ZRRE-së